



Në pajtim me autoritetin që i është dhënë përmes Ligjit Nr. 03/L-090 mbi Partneritetet Publiko - Private dhe Koncesionet në infrastrukturë si dhe procedurat për dhënien e tyre, Neni 12, Paragrafi 2.3, Komisioni Drejtues Ndërministror për Partneritetet Publiko-Private (KDNM-PPP) miraton këtë:

DIREKTIVË Nr. 1/2011

Mbi procedurat për shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve PPP

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Fushëveprimi

Një autoritet publik, siç përcaktohet në Ligjin PPP, i cili dëshiron ta procedojë një projekt PPP, i cili i nënshtrohet Ligjit për PPP dhe, nëse është e aplikueshme, Ligji për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMFPP), do t'iu bindet rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë Direktivë.

Neni 2: Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë Direktivë, përveç nëse përcaktohet ndryshe, do ta kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për PPP.

2. Për qëllime të kësaj Direktive:

“Përballueshmëria” do të nënkuptojë që zotimet financiare, që do të bëhen nga një autoritet publik në kuptimin e marrëveshjes PPP, mund të përmbushen nga fondet

- i. e përcaktuara brenda buxhetit ekzistues të autoritetit publik për shërbimin publik ose infrastrukturën publike me të cilën ndërlidhet marrëveshja PPP;
- ii. e destinuar për autoritetin publik në përputhje me parashikimet përkatëse buxhetore.

“LMFPP” do të nënkuptojë Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të amendamentuar.

“Marrëveshja PPP” do të nënkuptojë një kontratë koncesioni, një kontratë partneriteti publiko- privat apo ndonjë aranzhman institucional i cili rezulton në një Partneritet publiko- privat.

“KDNM-PPP” do të nënkuptojë Komisionin Drejtues Ndërministror për Partneritetet publiko- private, siç përcaktohet në Ligjin për PPP.

“Ligji PPP” do të nënkuptojë Ligjin Nr. 03/L-090 për Partneritetet publiko - private dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe procedurat për dhënien e tyre.

“Projekt” do të nënkuptojë një projekt Partneriteti publiko-privat.

3. Nenet do t'i referohen neneve të kësaj direktive, përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe.

4. Ditët do t'i referohen ditëve kalendarike, përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe.

PJESA II: KËRKESA PËR APROVIMIN E PROJEKTEVE PPP

Neni 3: Studimi i para-fizibilitetit

1. Pasi një autoritet publik ta bëjë identifikimin e një projekti potencial, autoriteti i tillë publik duhet ta zhvillojë një studim të para-fizibilitetit, i cili do ta ketë formatin si ai i bashkangjitur në Shtojcën I të kësaj Direktive.

2. Autoriteti publik duhet t'ia paraqesë Njësisë Qendrore për Partneritete Publiko Private (NJQPPP) një studim të tillë të para-fizibilitetit, e cila do ta ketë një afat prej 10 ditësh për ta shqyrtuar atë dhe për ti ofruar autoritetit përkatës publik një rekomandim nëse është apo nuk është e këshillueshme që të vazhdohet me projektin e parashikuar dhe nëse është i nevojshëm aprovimi i tij nga ana e KDNM-PPP apo Qeverisë. NJQPPP mundet, sipas nevojës, të kërkojë sqarime dhe materiale shtesë nga autoriteti publik. Në një rast të tillë, NJQPPP do t'ia ketë

10 ditë shtesë për ta përfunduar shqyrtimin dhe për ta nxjerrë një rekomandim.

3. Rekomandimi do të bazohet në një vlerësim *prima facie* (në dukje të parë) të rezultateve të studimit të parafizibilitetit përkitazi me kuadrin ligjor, institucional dhe rregullator, vlerën e ngjarë për para, përballueshmërinë, ndikimin ekonomik dhe social dhe ndërvendosjen e rrezikut. Rekomandimi do të përfshijë një vlerësim të nevojës për një këshilltar transaksioni.

Neni 4: Dorëzimi i projekt-propozimeve PPP

1. Një autoritet publik që dëshiron të vazhdojë me procedurat e prokurimit për një projekt, i cili i nënshtrohet aprovimit të KDNM-PPP, në pajtim me Ligjin PPP, ose Qeverisë, në përputhje me LMFPP, do t'i dorëzojë KDNM-PPP, përmes Njësisë Qëndrore për PPP, dokumentet e mëposhtme të projektit, të cilat së bashku përbëjnë propozimin e projektit:
 - i. Një kërkesë me shkrim për aprovim,
 - iii. Një studim fizibiliteti,
 - iv. Draft dokumentet e tenderit,
 - v. Një kërkesë për aprovim të mbështetjes ekonomike, nëse ka.
2. Propozimi i projektit do të dorëzohet nga një përfaqësues i autorizuar i autoritetit përkatës publik para fillimit të çdo procedure të prokurimit në lidhje me projektin e propozuar në studimin e fizibilitetit. Asnjë procedurë e prokurimit në lidhje me një projekt nuk mund të iniciohet ose zhvillohet nga një autoritet publik deri sa KDNM-PPP nuk e aprovon me shkrim projektin dhe me kusht që çdo procedurë pasuese e prokurimit dhe marrëveshje PPP e dhënë është në përputhje me pëlqimin e dhënë nga KDNM-PPP.

Neni 5: Studimi i fizibilitetit

Studimi i fizibilitetit do të përmbajë, ku gjen zbatim, si në vijim:

- (i) Informacione të përgjithshme mbi projektin, duke përfshirë një përshkrim të detajuar të projektit dhe qëllimet e tij, titullin/emrin e autoritetit publik, emrin dhe funksionin zyrtar të personit që përfaqëson autoritetin publik, emrat dhe funksionet zyrtare të personit/ave të cilët janë anëtarë të ekipit të projektit të autoritetit publik;
- (ii) Fizibilitetin ekonomik dhe inxhinierik të projektit të propozuar PPP;
- (iii) Një analizë të nevojave, duke përfshirë objektivat strategjike të autoritetit publik, buxhetin dhe përballueshmërinë, specifikimet e rezultateve, dhe një analizë institucionale që ka të bëjë me kapacitetin e autoritetit publik për të prokuruar, zbatuar, menaxhuar, imponuar, monitoruar dhe raportuar mbi PPP;
- (iv) Hulumtimin dhe mbledhjen e informatave (Due diligence) për projektin, duke përfshirë një due diligence ligjore, rregullatore, ekonomike dhe mjedisore dhe një konsultim me palëve të interesuara;
- (v) Një matricë mbi shpërndarjen e rrezikut të projektit;
- (vi) Fizibilitetin financiar dhe vlerësimin e vlerës që reflekton vlerën për para të projektit në bazë të një modeli krahasues të sektorit publik (kur nevojitet), analizën e vlerësimin të rrezikshmërisë, modelin krahasues të sektorit publik të përshtatur ndaj rrezikut, modelin PPP të përshtatur ndaj rrezikut si dhe vlerësimin ekonomik.
- (vii) Hollësitë mbi çdo shumë, formë dhe kohëzgjatje të propozuar të mbështetjes së nevojshme ekonomike;
- (viii) Strukturën e PPP, duke përfshirë të gjitha opsionet e marra në konsideratë, një vlerësim të secilit opsion dhe një arsytim të strukturës së rekomanduar PPP;

Neni 6: Draft dokumentet e prokurimit

1. Draft dokumentet e prokurimit do të dorëzohen në formën e përcaktuar në Ligjin për PPP dhe Ligjin për Prokurimin Publik, siç mund të jetë e zbatueshme.

2. Draft dokumentet e prokurimit do të përfshijnë një draft-marrëveshje PPP, e cila, së paku, do të përmbajë të gjitha elementet e përcaktuara në Ligjin për PPP.

Neni 7: Kërkesa për mbështetje ekonomike

1. Në rast se një projekt ka nevojë për mbështetje ekonomike, atëherë autoriteti publik, së bashku me propozimi-projektin, do ta dorëzojë poashtu edhe një kërkesë për miratimin e një mbështetje të tillë ekonomike.
2. Në mënyrë që kërkesa për aprovimin e mbështetjes ekonomike të shqyrtohet dhe të aprovohet, studimi i fizibilitetit duhet të përfshijë gjithashtu një përshkrim të hollësishëm të llojit, shumës së propozuar dhe kohëzgjatjes së mbështetjes së kërkuar ekonomike. Në rast se mbështetja e kërkuar ekonomike përfshin pagesat e disponueshmërisë për partnerin privat, autoriteti publik duhet të paraqesë një vlerësim paraprak të buxhetit që mbulon pagesat e disponueshmërisë sipas marrëveshjes së paraparë PPP përgjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes PPP.

PJESA III: PROCESIMI I KËRKESAVE PËR APROVIM TË PROJEKTEVE PPP

Neni 8: Regjistrimi i projekt-propozimeve

1. Njësia Qendrore për PPP do ta regjistrojë çdo projekt-propozim i cili është paraqitur nga një autoritet publik.
2. Njësia Qendrore për PPP do t'ia caktoj çdo projekt-propozim një numër skedari dhe do ta gjenerojë një skedar të veçantë për secilin projekt-propozim.
3. Njësia Qendrore për PPP do ta regjistrojë çdo projekt-propozim dhe do t'ia caktojë një numër skedari sipas datës dhe kohës së dorëzimit të tij. Projekt-propozim e dorëzuara në një datë dhe kohë të mëhershme, për qëllime të shqyrtimit të tyre, do të kenë përparësi ndaj projekt-propozimeve të dorëzuara në një datë dhe kohë të mëvonshme, përveç nëse kjo nuk përcaktohet ndryshe me shkrim nga ana e Kryesuesit të KDNM-PPP.
4. Nëse projekt-propozimi nuk përfshin të gjitha dokumentet e projektit, siç kërkohet nga kjo direktivë, Njësia Qendrore për PPP do t'ia caktojë autoritetit publik një afat kohor prej jo më shumë se 30 ditë për ta plotësuar projekt-propozimin. Dështimi për ta kompletuar projekt-propozimin brenda afatit të përcaktuar do të konsiderohet si tërheqje e projekt-propozimit nga ana e autoritetit publik dhe i njëjti nuk do të përpunohet më tutje. Në rast se autoriteti publik dëshiron ta ndjek këtë projekt pas skadimit të afatit të tillë, i njëjti duhet ta paraqesë një projekt-propozim të ri, të cilit do t'ia caktohet një numër të ri skedari sipas datës dhe kohës së dorëzimit të tij.

Neni 9: Shqyrtimi nga ana e Njesisë Qendrore për PPP

1. Njësia Qendrore për PPP do ta shqyrtojë një projekt-propozim vetëm nëse i njëjti përfshin të gjitha dokumentet e projektit të cilat kërkohen në këtë Direktivë, pavarësisht çdo informacioni dhe dokumentacioni shtesë i cili mund të kërkohet gjatë procesit të shqyrtimit.
2. Njësia Qendrore për PPP do ta shqyrtojë projekt-propozimin kundrejt kritereve, të cilat mund të përfshijnë, por që nuk do të kufizohen në:
 - (i) Dokumentet e projektit janë të kompletuara dhe dorëzuara në përputhje me këtë Direktivë;
 - (ix) Ligji për PPP mbulon projektin e propozuar;
 - (x) Autoriteti publik ka kompetencën ligjore për të siguruar infrastrukturën publike ose shërbimin publik të propozuar;
 - (xi) Ekziston një nevojë e justifikuar publike për infrastrukturën publike të propozuar ose shërbimin publik

- të bazuar në një realizueshmëri sociale dhe ekonomike;
- (xii) Projekti i propozuar është në përputhje me objektivat e përcaktuara në strategjitë sektoriale përkatëse;
 - (xiii) Autoriteti publik siguron financim adekuat gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit për t'i përmbushur detyrimet e mundshme financiare;
 - (xiv) Projekti i propozuar është teknikisht i realizueshëm dhe të çon në sigurimin e një infrastrukture publike ose shërbimi publik të ri të cilin autoriteti publik nuk mund ta siguronte vet, rritje të efikasitetit dhe/ose përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të infrastrukturës publike ekzistuese ose të shërbimeve publike;
 - (xv) Projekti i propozuar është financiarisht i realizueshëm dhe i pranueshëm nga bankat, nëse është e aplikueshme;
 - (xvi) Projekti i propozuar dëshmon vlerë pozitive për para, nëse është e aplikueshme;
 - (xvii) Projekti i propozuar është i përballueshëm për buxhetin e autoritetit publik përkatës;
 - (xviii) Projekti i propozuar është në gjendje t'i tërheq partnerët privat dhe/ose financimin privat.
3. Njësia Qendrore për PPP duhet ta shqyrtojë projekt-propozimin në një afat brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tij në përputhje me nenin 8 të kësaj Direktive. Njësia Qendrore për PPP mund të vazhdojë procesin e shqyrtimit për 30 ditë të tjera, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për arsye të forta përkitazi me ndërlikueshmërinë e projekt-propozimit. Në raste të tilla, Njësia Qendrore për PPP do ta informojë autoritetin përkatës publik me shkrim në lidhje me vazhdimin e afatit dhe t'i ofrojë arsyet për këtë.
 4. Pas regjistrimit të projekt-propozimit, Njësia Qendrore për PPP menjëherë do t'i dorëzojë Departamentit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave një kopje të studimit të fizibilitetit dhe të kërkesës për mbështetje ekonomike. Brenda 30 ditësh nga marrja e projekt-propozimit, Departamenti i Buxhetit do ta vlerësojë përballueshmërinë buxhetore të projekt-propozimit, duke përfshirë edhe ndonjë mbështetje ekonomike që mund të kërkohej sipas strukturës së propozuar PPP dhe implikimet e saja buxhetore, dhe të ofrojë Njësisë Qendrore për PPP vlerësimin dhe rekomandimin e tij me shkrim.
 5. Sa herë që, brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të kësaj direktive, Njësia Qendrore e PPP përcakton se një projekt-propozim nuk i përmbush në mënyrë të kënaqshme një ose më shumë nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, do t'i ftojë përfaqësuesit e autorizuar të autoritetit publik përkatës për të paraqitur prova mbështetëse shtesë dhe për të diskutuar të metat e projekt-propozimit. Takimi do të mbahet jo më vonë se 5 ditë nga dita kur NJQPPP ka vërtetuar mangësitë e tilla. Gjatë takimit të tillë, NJQPPP do t'ia shpjegojë përfaqësuesit të autorizuar të autoritetit publik mangësitë e identifikuar nga NJQPPP dhe të ofrojë, nëse është e mundur, rekomandimet për përmirësimin e projekt-propozimit. Përfaqësuesi i autorizuar i autoritetit publik mund të shoqërohet nga personat të cilët kanë marrë pjesë në përgatitjen e projekt-propozimit. Autoriteti publik do t'i ketë 30 ditë për t'i bërë projekt-propozimit përmirësimet e nevojshme. Dështimi i autoritetit publik për të marrë pjesë në takim ose dështimi për të paraqitur projekt-propozimin me përmirësimet e nevojshme brenda afatit të specifikuar do të rezultojë me një rekomandim të menjëhershëm të NJQPPP për KDNM-PPP për ta refuzuar projekt-propozimin.
 6. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit, NJQPPP do t'ia paraqesë KDNM-PPP projekt-propozimin për shqyrtim së bashku me rekomandimin e tij për të pranuar ose refuzuar projekt-propozimin. NJQPPP do të ofrojë një shpjegim të hollësishtë me shkrim në lidhje me arsyet e rekomandimit.

Neni 10: Shqyrtimi nga ana e KDNM-PPP

1. KDNM-PPP do ta shqyrtojë projekt-propozimin duke marrë parasysh rekomandimet e bëra nga NJQPPP dhe Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave. KDNM-PPP, do ta vlerësojë projekt-propozimin kundrejt kriterëve të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 2, të kësaj direktive.
2. KDNM-PPP mund ta aprovojë apo refuzojë projekt-propozimin, ose të propozojë modifikime me qëllim të maksimalizimit të vlerës për para dhe përballueshmërinë e projektit. Në rast se KDNM-PPP refuzon projekt-propozimin ose propozon modifikime, ajo, nëpërmjet NJQPPP, do të ofrojë një shpjegim me shkrim për arsyet e tyre.
3. Nëse KDNM-PPP propozon modifikime, ai do t'i përcakton autoritetit përkatës publik një afat prej jo më shumë se 30 ditë për t'i bërë rregullimet e domosdoshme në projekt-propozim, në përputhje me modifikimet e

propozuara nga KDNM-PPP. Pas skadimit të afatit, KDNM-PPP do ta aprovojë apo refuzojë një propozim të tillë, varësisht faktit nëse autoriteti publik ka paraqitur një projekt-propozim të modifikuar brenda afatit të përcaktuar nga KDNM-PPP dhe nëse ndonjë projekt-propozim i modifikuar i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Nenin 9, paragrafi 2, të kësaj direktive.

Neni 11: Aprovimi i kushtëzuar i projekt- propozimit

KDNM-PPP mund t'i vë kushte aprovimit të një projekt-propozimi nga ana e tij, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kushtet, të cilat do të përcaktohen në kërkesën për propozim si të panegociueshme. Autoriteti publik duhet t'i përmbush të gjitha kushtet e ndërlidhura me aprovimin dhe nuk do të iniciojë dhe kryejë çfarëdo procedure të prokurimit e cila është në kundërshtim me kushtet e tilla.

Neni 12: Aprovimi i mbështetjes ekonomike

1. Një projekt, i cili është një kontratë koncesioni, siç përcaktohet në Ligjin për PPP që kërkon mbështetje ekonomike dhe që është miratuar nga KDNM-PPP, në përputhje me këtë direktivë, do t'i nënshtrohen aprovimit final nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç parashihet në LMFP.
2. Në rast se Qeveria refuzon miratimin e mbështetjes së nevojshme ekonomike, projekti i propozuar do të konsiderohet të jetë refuzuar nga KDNM-PPP.

PJESA IV: PROCEDURA E PROKURIMIT

Neni 13: Njësia për implementim të projektit

1. Çdo autoritet publik, i cili zhvillon dhe zbaton një projekt, do të themelojë dhe të mbajë një Njësi për Implementimin e Projektit (NJIP) të kualifikuar profesionalisht dhe me përvojë, me ekspertizë në ligjin e kontratës dhe prokurimin publik, financa dhe buxhet, menaxhim të projektit, dhe ekspertizë specifike teknike dhe inxhinierike të projekteve. NJIP do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e studimit të para-fizibilitetit, projekt-propozimit dhe dokumenteve të prokurimit dhe për kryerjen e procedurës së prokurimit. Njësia për implementimin e projektit do të udhëhiqet nga një shërbyes i lartë civil i autoritetit publik përkatës.
2. Autoriteti publik mund të kontrakttojë, në përputhje me rregulloret e prokurimit në fuqi, një këshilltar transaksioni dhe ndonjë ekspertizë tjetër të domosdoshme për qëllim të ndihmesës në përgatitjen e studimit të para-fizibilitetit, projekt-propozimit dhe dokumenteve të prokurimit.

Neni 14: Procedura për monitorim të prokurimit

1. Kurdo që një projekt kërkon aprovimin e KDNM-PPP, në pajtim me Ligjin për PPP, apo aprovimin e Qeverisë, në përputhje me LMFP, asnjë autoritet publik nuk mund të fillojë ose të zhvilloj prokurimin për dhënien e një kontrate PPP ose jap një marrëveshje PPP përveç nëse projekti i tillë është miratuar nga KDNM-PPP dhe, nëse kërkohet përmes LMFP, nga Qeveria.
2. NJQPPP do ta monitorojë procedurën e prokurimit të zhvilluar nga autoriteti publik, me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me projekt-propozimin e miratuar nga KDNM-PPP. Për këtë qëllim, NJQPPP mund të kërkojë në çdo kohë nga autoriteti përkatës publik të ofrojë detajet e procesit të prokurimit i cili është në vazhdim e sipër, duke përfshirë detajet e negociatave me ofertuesit dhe draft-marrëveshjet PPP.
3. Në rast se NJQPPP përcakton se autoriteti publik është duke zhvilluar procedura të prokurimit ose negociatave, të cilat do të rezultojnë në një marrëveshje PPP, e cila nuk është në përputhje me projektin e miratuar nga KDNM-PPP, NJQPPP do të informojë menjëherë KDNM-PPP në lidhje me këtë. Në raste të tilla, KDNM-PPP mund t'ia ndalojë autoritetit publik të procedojë me procedurat e prokurimit ose negociatat ose përmbylljen e një marrëveshjeje PPP.

Neni 15: Aprovimi i dhënies së kontratës

1. Para dhënies së një marrëveshjeje PPP, autoriteti publik do ta dorëzojë tekstin përfundimtar të marrëveshjes PPP që do të jepen për shqyrtim nga KDNM-PPP. KDNM-PPP do t'i ketë 15 ditë në dispozicion për ta shqyrtuar një marrëveshje PPP për të siguruar se marrëveshja e tillë është në përputhje me projektin e miratuar nga KDNM-PPP.
2. KDNM-PPP do të ndalojnë dhënien e marrëveshjes PPP nëse konstaton se teksti përfundimtar i marrëveshjes PPP ndryshon thelbësisht nga projekti i miratuar nga ana e KDNM-PPP, dhe në çdo rast, nëse marrëveshja PPP nuk i plotëson kërkesat e përballeshmërinë dhe vlerës për para, nëse është e aplikueshme.
3. Nëse marrëveshja PPP, siç është përcaktuar në LMFPP, kërkon mbështetje ekonomike, të tilla marrëveshje PPP do t'i nënshtrohen miratimit të qeverisë, siç kërkohet nga LMFPP para dhënies së tyre.
4. Në rast se KDNM-PPP ndalon dhënien e një marrëveshjeje PPP apo Qeveria refuzon aprovimin e saj në përputhje me LMFPP, autoriteti publik nuk do ta jap marrëveshjen PPP.

Neni 16: Monitorimi pas dhënies së kontratës

1. Pas dhënies së marrëveshjes PPP, në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, Ligji PPP dhe, nëse është e aplikueshme, LMFPP, NJQPPP do t'i monitorojë negociatat dhe përfundimin e çdonjëres dhe marrëveshjeve ndihmëse të ndërlidhura me marrëveshjen PPP, duke përfshirë, por jo kufizuar, marrëveshjet financiare, marrëveshjet dhe operacionet e drejtpërdrejta dhe marrëveshjet për menaxhim, në mënyrë që të sigurojnë që çdo marrëveshje e tillë të jetë në përputhje me marrëveshjen PPP dhe projektin e aprovuar nga KDNM-PPP.
2. Në rast se NJQPPP përcakton se autoriteti publik është duke zhvilluar negociata, të cilat do të rezultojnë në një marrëveshje, e cila nuk është në përputhje me marrëveshjen PPP apo projektin e aprovuar nga KDNM-PPP, NJQPPP do ta informojë menjëherë KDNM-PPP në lidhje me to. Në raste të tilla, KDNM-PPP mund ta ndalojnë autoritetin publik të procedojë me negociatat ose përmbylljen e një marrëveshjeje të tillë.
3. Për qëllim të mundësisimit të NJQPPP t'i ushtrojë në mënyrë efektive përgjegjësitë e veta sipas këtij neni, autoriteti publik përkatës do të lejoj përfaqësuesve të NJQPPP qasje të pakufizuar në dokumentet relevante, materialeve dhe takimet.

PJESA V: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17: Vazhdimi i afateve përfundimtare

Pas rekomandimit me shkrim dhe arsytimit të NJQPPP, KDNM-PPP mundet, në lidhje me ndonjë projekt të veçantë, me shkrim, ta vazhdojë çdo afat të përcaktuar në këtë direktivë për një periudhë kohore që nuk tejkalon 90 ditë, nëse kjo është e domosdoshme duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e një projekt-propozimi ose ndonjë rrethane tjetër detyruese.

Neni 18: Hyrja në fuqi

Kjo direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të tij nga ana e KDNM-PPP dhe nënshkrimit të tij nga Kryesuesi i KDNM-PPP.

